

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-552 W Aquaprimer

PRAJMER ME BAZË UJI PËR VESHJE



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard®-552 W Aquaprimer është prajmer me 1 përbërës i shpërndarë në ujë për përmirësimin e ndërkapjes të veshjeve me bojëra polimere të shpërndara në ujë. Sikagard®-552 W Aquaprimer është pjesë e një sistemi i cili plotëson kërkesat e EN 1504-2 si veshje mbrojtëse.

PËRDORIMET

Veshje prajmeri për nënshtresa betoni dhe minerali të dendur si çimento me fibra, aerobeton, gips dhe suva të hollë si Sika® MonoTop®-723N, Icoment-520 etj. Sikagard®-552 W Aquaprimer mund të përdoret gjithashtu si një prajmer mbi veshjet ekzistuese me bazë uji dhe ndërkapje të fortë ose poshtë llaçit meremetues me bazë çimentoje për të përmirësuar ndërkapjen në rast sipërfaqeje betoni të trajtuar me impregnim hidrofobik.

Sikagard®-552 W Aquaprimer është pjesë e sistemit:

- I përshtatshëm për mbrojtje kundër hyrjes së ujit (Parimi 1, metoda 1.3, EN 1504-9),
- I përshtatshëm për kontroll të lagështisë (Parimi 2, metoda 2.3, EN 1504-9)
- I përshtatshëm për rritje të rezistencës (Parimi 8, metoda 8.3, EN 1504-9)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Dispersion ujqor - pa tretës
- Miqësor ndaj mjedisit
- I përkushëm nga avujt e ujit
- Mund të përdoret si përmirësues i ndërkapjes për veshjet ose llaçin meremetues me bazë çimentoje

MIRATIME / STANDARDE

- Raport testimi nga IBAC Aachen dd 07.04.1993 në kombinim me Sikagard®-545 W Elastofill.
- Raport testimi sipas ZTV-SIB OS DII nga Instituti i Polimereve dd 16.10.0; Nr. P 2703/01-125.
- Veshje mbrojtëse sipas EN 1504-2, DoP 02 03 03 06 002 0 000002 1125; certifikuar nga organi i kontrollit të prodhimit në fabrikë 0921; certifikatë 0921-BPR-2046 dhe mbart markën CE

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Dispersion akrilati
Ambalazhi	kovë plastike 10 l
Paraqitja / Ngjyra	Lëng ngjyrë qumështi
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin original të pahapur dhe të padëmtuar.
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në kushte të freskëta dhe të thata. Të mbrohet nga rrezatimi drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.

Dendësia ~1.0 kg/l (në 20 °C)

Përmbajtja e substancave të ngurta për ~20 %
vëllim

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit 1 x Sikagard®-552 W Aquaprimer

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	~0.10-0.12 kg/m ² (~8-10 m ² për litër) në varësi të absorbueshmërisë së nënshtresës.								
Temperatura e mjedisit	+8 °C min. / +35 °C max.								
Lagështia relative e ajrit	< 80 %								
Pika e vesës	Temperatura e nënshtresës dhe ambientit duhet të jenë të paktën 3°C mbi pikën e vesës.								
Temperatura e nënshtresës	+8 °C min. / +35 °C max.								
Koha e pritjes / mbiveshja	Kohet e pritjes përpara veshjes: <table><thead><tr><th>Temperatura e nënshtresës</th><th>Koha</th></tr></thead><tbody><tr><td>+8 °C</td><td>12 orë</td></tr><tr><td>+20 °C</td><td>5 orë</td></tr><tr><td>+35 °C</td><td>2.5 orë</td></tr></tbody></table> <p>Shënim: Kur aplikimi bëhet mbi veshjen ekzistuese, koha e pritjes përpara mbiveshjes me prajmerin do të rritet me 100%. Përdorni sisteme veshjeje vetëm me bazë uji mbi Sikagard®-552 W Aquaprimer. Kur përdoret si prajmer poshtë llaçit meremetues me bazë çimentoje, aplikoni llaçin kur prajmeri është ende i ngjithshëm. Nëse prajmeri është tharë plotësisht, aplikoni sërish 1 veshje.</p>	Temperatura e nënshtresës	Koha	+8 °C	12 orë	+20 °C	5 orë	+35 °C	2.5 orë
Temperatura e nënshtresës	Koha								
+8 °C	12 orë								
+20 °C	5 orë								
+35 °C	2.5 orë								
Metoda e maturimit	Sikagard®-552 W Aquaprimer nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë, por duhet të mbrohet nga shiu për të paktën 30 minuta në +20 °C.								

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të jetë e dendur dhe pa grimca të lira dhe të shkrifëta.

Rezistenca e nënshtresës ndaj tërheqjes duhet të jetë më e lartë se 1 N/mm².

Beton i ekspozuar pa veshje ekzistuese

Metoda të përshtatshme përgatitjeje janë pastrimi me avull, curril uji në presion të lartë ose pastrim me fryrje. Betoni i ri duhet të ketë moshë prej të paktën 28 ditësh.

Shtresë e hollë suvatimi

Nëse kërkohet, mund të aplikohet një izolues poresh nivelues (p.sh. Sika® MonoTop®-723 N, Icoment-520, Sikagard®-545 W Elastofill, etj.) - referohuni në skedën teknike përkatëse. Për produktet me bazë çimentoje, lini kohë tharjeje prej të paktën 4 ditësh përpara aplikimit të prajmerit.

Beton i ekspozuar me veshje ekzistuese

Veshjet ekzistuese duhet të testohen për të konfirmuar ndërkapjen e tyre me nënshtresën - mesatarja e testimit të ndërkapjes: > 1.0 N/mm² pa asnjë vlerë të vetme nën 0.7 N/mm² për veshjen përfundimtare vijuese të ngurtë; > 0.8 N/mm² pa asnjë vlerë të vetme nën 0.5 N/mm² për veshjen

përfundimtare vijuese elastike - referohuni tek Method Statement përkatëse për më shumë detaje.

- Për veshje me bazë uji, përdorni Sikagard®-552 W Aquaprimer si prajmer
- Për veshje me bazë tretësi, përdorni Sikagard®-551 S Elastic Primer - referohuni tek skeda teknike
- Në rast dyshimi, kryeni një testim të ndërkapjes për të përcaktuar se cili prajmer është më i përshtatshëm - prisni të paktën 2 javë pas aplikimit përpara se të kryeni testimin e ndërkapjes sipas EN 1542

APLIKIMI

Sikagard®-552 W Aquaprimer është gati për përdorim; mos e holloni. Përziëni mirë përpara aplikimit. Sikagard®-552 W Aquaprimer mund të aplikohet me furçë, rul ose spërkatje pa ajër.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë të pastër menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

Mos aplikoni kur:

- Pritet shi
- Betoni është më i ri se 28 ditësh

Mos aplikoni llaç meremetimi mbi Sikagard®-552 W Aquaprimer që është tharë - ngjitja e llaçit mund të dëmtohet.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

UDHËZIMI 2004/41/CE - KUFIZIMI I EMETIMEVE TË LIDHJEVE ORGANIKE FLURORE

Sipas Udhëzimit të BE 2004/42, përmbajtja maksimale e lejuar e VOC (Kategori produkti IIA / g lloji wb) është 30 (Kufizimi 2010) për produktin gati për përdorim. Përmbajtja maksimale e Sikagard®-552 W Aquaprimer është < 30 g/l VOC për produktin gati për përdorim.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikagard®-552 W Aquaprimer
Mars 2019, Botimi 02.01
020303060020000002

Sikagard-552WAquaprimer-sq-AL-(03-2019)-2-1.pdf

